

URDHËR
Nr. 600, datë 16.6.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË PESTËS SË RUMINANTËVE
TË VEGJËL TË SHFAQUR NË SHTETIN E BULLGARISË DHE RUMANISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nga i gjithë territori i Republikës së Bullgarisë dhe Rumanisë në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) kafshëve të gjalla të llojit të ruminantë të vegjël dhe ruminantë të vegjël të egër;
- b) materialit biologjik dhe embrioneve;
- c) miellit të mishit dhe miellit të gjakut, kockat pa dhjamë, thundra, kthetra dhe brirë
- d) leshin, lëkurën e papërpunuar dhe lëkurën e ruminantëve të vegjël;
- dh) trofetë e gjuetisë dhe preparate të destinuara për muze nga ruminantët e vegjël;
- e) produktet me origjinë shtazore për përdorim farmaceutik ose kirurgjikal, të kafshëve të llojit ruminantë të vegjël.

2. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit të ruminantë të vegjël, ruminantë të vegjël të egër, materialit biologjik, embrioneve, miellit të mishit dhe miellit të gjakut, kockat pa dhjamë, thundra, kthetra dhe brirë, leshin, lëkurën e papërpunuar dhe lëkurën e ruminantëve të vegjël, trofetë e gjuetisë dhe preparate të destinuara për muze nga ruminantët e vegjël, produktet me origjinë shtazore për përdorim farmaceutik ose kirurgjikal, të kafshëve të llojit ruminantë të vegjël.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojë të gjithë subjektet importuese të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit të ruminantë të vegjël, ruminantë të vegjël të egër, materialit biologjik, embrioneve, miellit të mishit dhe miellit të gjakut, kockat pa dhjamë, thundra, kthetra dhe brirë, leshin, lëkurën e papërpunuar dhe lëkurën e ruminantëve të vegjël, trofetë e gjuetisë dhe preparate të destinuara për muze nga ruminantët e vegjël, produktet me origjinë shtazore për përdorim farmaceutik ose kirurgjikal, të kafshëve të llojit ruminantë të vegjël.

4. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi më datë 18.6.2025 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj